

ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea
AID 011523/VIS/ALB

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, më datë xxxxxxxx në Koplik (Shqipëri), midis palëve:

- **VIS – Albania**, me qendër në Tiranë, Rruga Don Bosko”, Pallati Grapshi, Tiranë– Shqipëri dhe me zyre operative ne Koplik, Pallati Hehaj, ne kuader te projektit “Zana e Maleve- Rinia dhe Territori: rrenjet e nje komuniteti ne rrugen drejt integritit me familjen evropiane”, me protokoll AID 011523/VIS/ALB, financuar nga AICS–Agjensia e Bashkpunimit per Zhvillim dhe perfaqesuar nga Znj. Anna Carboni, me karte identiteti nr AS3477817, si koordinatore e projektit;

dhe

- **xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx**, me nr. NIPT xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, me adrese xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, përfaqësuar nga Z. xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx si xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx.

konfirmojmë këtë **partneritet** në kuadër të komponentit të Bursave të Punës, si aktivitete për mbështetjen e punësimit të të rinjve të Malësisë së Madhe në mënyrë që të ulim emigracionin dhe braktisjen e shkollës.

Për të siguruar një zbatim sa më të mirë të aktiviteteve është e nevojshme që partnerët të firmosin parimet kryesore të partneritetit, **dy palët bien dakord si më poshtë:**

A- TE DREJTAT DHE DETYRIMET E VIS ALBANIA

1. VIS Albania, në bashkëpunim me partnerët e saj të projektit, ka përzgjedhur **Znj. xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx** si përfituese e bursës së punës (*bashkëngjitur karta e identitetit*).

2. VIS Albania përzgjedh Mbikqyrësin e Burses së Punës, detyra e të cilit do të jetë lehtësimi i raporteve të punës mes ndërmmarrjes (bisnesit) dhe organizatës, të rregulluara me marreveshje të veçante.

3. VIS Albania nepërmjet Mbikqyresit ndjekë ecurine në punë të të riut dhe merr informacion të vazhdueshëm nga Tutor në lidhje me mbarevajtjen e procesit.

4. VIS Albania mban kontaktë të vazhdueshme si me ndërmarrjen ashtu edhe me Mbikqyrësin, në lidhje me realizimin e detyrave të punonjësit.

5. VIS Albania angazhohet të kontribuojë në mbulimin e shpenzimeve, paga dhe sigurime per nje periudhe tre mujore (nga data xxxxxxxxxxxx deri xxxxxxxxxxxx). Paga që VIS Albania do ti kalojë Punëdhënësit, e llogaritur në muaj **bruto** (me taksa dhe kontribute) është **xxxxxxxxxxxxx (xxxxxxxxxxxxx) Lekë, neto** është **xxxxxxxxxxxxx (xxxxxxxxxxxxx) Lekë. Kosto totale** eshte barabarte me shumen **xxxxxxxxxxxxx (xxxxxxxxxxxxx) Lekë**.

Emri i bankës: xxxxxxxxxxxx

In collaborazione con:



Fondazione Slow Food
per la Biodiversità Onlus



ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea
AID 011523/VIS/ALB

Emri i subjektit: xxxxxxxxxxxxxxxx

IBAN: xxxxxxxxxxxxxxxx

7. VIS Albania do të kryejë pagesën një herë në muaj, ne datat 28-30 te muajit, me transfertë bankare në llogarinë e caktuar të Bisnesit duke përcaktuar arsyen dhe emrin e të riut për të cilin paguhet vlera.

8. VIS Albania ka të drejtë për të kërkuar te bisnesi një herë në muaj, vertetimin e pagesës te konto e punëmarrësit dhe e pagesës të taksave dhe kontributeve.

B- TE DREJTAT DHE DETYRIMET E BISNESI

1. Ndërmarrja (bisnesi) merr përsipër të nënshkruaje një kontratë punë me punonjës in në përputhje me Kodin e Punës dhe të gjitha aktet ligjore në fuqi në këtë fushë. Një kopje e kësaj kontrate duhet ti jepet edhe VIS Albania.

2. Ndërmarrja (bisnesi) regjistron punonjës in (sigurime shoqërore, tatime) duke bërë deklaratimet përkatëse pranë tyre.

3. Ndërmarrja (bisnesi) do të bëjë pagesën nëpërmjet bankës njëherë ne muaj nga dt 2-4 dhe do të plotësoje dokumentacionin.

Çdo muaj ndërmarrja do të dorëzojë një kopje të dokumentacionit:

- transfertë bankare për pagesen e punëmarrësit;
- transferten bankare për pagesen e kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- listëpagesen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4. Ndërmarrja (bisnesi) nga dt. 5-7 te muajit paraqet dokumentacionin për pagën dhe sigurimet e paguara për punonjës in për muajin paraardhës.

5. Ndërmarrja (bisnesi) merr përsiper ti ofroje punonjës it kushte pune të tilla që e lejojnë atë në përmbushjen dhe zhvillimin e aftësimin e tij profesional, dhe realizimin e punës së kërkuar.

6. Ndërmarrja (bisnesi) ka detyrim të respektojë dhe të mbrojë në raportet e punës personalitetin e punëmarrësit si dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendore të punonjësve si dhe parandalon çdo qendrim që cenon dinjitetin e punonjës it

7. Ndërmarrja (bisnesi) gjatë marrëdhënieve të punës është i detyruar të marrë masa sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale të punëmarrësit.

In collaborazione con:

ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea
AID 011523/VIS/ALB

8. Ndërmarrja (bisnesi) duhet të parandalojë aksidentet dhe sëmundjet profesionale dhe të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik.

9. Ndërmarrja (bisnesi) në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin mes punonjësit dhe subjektit, duhet të njoftojë menjëherë Mbikqyresin, në pamundësi për ta zgjidhur nga ana e tij, duhet t'i drejtohet VIS Albania.

C- KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kontrata zgjat 3 (tre) muaj, nga data xxxxxxxxxxxx deri xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx.

D -DOKUMENTET QË I BASHKËNGJITEN KONTRATËS

- a) Dokument identiteti i punëmarrësit;
- b) Raport mjeko-ligjor i punëmarrësit;
- c) Dëftesë ose Diplomë, të njehsuar me origjinalin (nëse ka);
- d) Librezë pune (nëse ka);
- e) NIPT i bisnesit;
- f) Vetë-deklarim që bisnesi nuk ka asnjë detyrim ndaj institucioneve shtetërore;
- g) Deklaratë anti-korrupsion të firmosur prej bisnesit.

E -TË NDRYSHME

Për çdo ndryshim në rregullat e kontratës, nevojitet njoftim 15 dite para datës që parashikohet ndryshimi, dhe dakortësi nga të dyja palët.

Marrëveshja konsiston në plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve nga ana e të dyja palëve, të vetëdijshme dhe krejtësisht dakort në momentin e firmosjes së kësaj marrëveshje.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga personat e autorizuar.

Për VIS – Albania

xxxxxxxxxxxx

Për xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

In collaborazione con:



Fondazione Slow Food
per la Biodiversità Onlus

